



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

KOMISIONI PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI, KULTURË, RINI DHE SPORT

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2016

Prishtinë, 16 shkurt 2016

Kryetari i Komisionit
Nait Hasani

P Ë R M B A J T J A

Tabela e shkurtesave	3
Hyrje	4
I. Anëtarët e Komisionit dhe njësia mbështetëse	5
II. Fushëveprimtaria e Komisionit	6
III. Objektivat	7
IV. Rregulla për organizimin e brendshëm	8
V. Plani i punës së Komisionit (pjesa tekstuale).....	10
VI. Agjenda e punës së Komisionit sipas muajve (pjesa tabelore)	12
<i>SESIONI PRANVEROR(JANAR – 31 KORRIK 2016)</i>	
1. Projektligjet në procedurë jashtë Programit Legjislativ të Qeverisë për vitin 2016	12
a) Projektligjet, në pritje për shqyrtim të parë	12
b) Projektligjet në procedurë të shqyrtimit në Komision	12
2. Projektligjet nga Programi legjislativ i Qeverisë për vitin 2016	13
3. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve	13
4. Raportimi i agjencive të pavarura	13
5. Shqyrtimi i raportit vjetor të shpenzimeve të Ministrive	14
6. Shqyrtimi i raportit gjashtë(6) mujor të shpenzimeve të Ministrive	14
<i>SESIONI VJESHTOR(SHTATOR – 31 DHJETOR 2016)</i>	
1. Shqyrtimi i dytë i projektligjeve	15
2. Projektligjet nga Programi legjislativ i Qeverisë për vitin 2016	15
3. Shqyrtimi i raportit nëntë(9) mujor të shpenzimeve të Ministrive	16

TABELA E SHKURTESAVE

KUVENDI	Kuvendi i Republikës së Kosovës
KOMISIONI	Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport
GRUPI I PUNËS	Grupi i punës i ngritur nga Komisioni për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit ose shqyrtimit të projektligjit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MeD	Ministria e Diasporës
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
KKTK	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë
AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
GIZ	Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim zyra në Kosovë
USAID	Agjencia për Zhvillim e Shteteve të Bashkuara
NDI	Instituti Demokratik Kombëtar
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës

HYRJE

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në bazë të nenit 69 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është një nga komisionet funksionale. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësive, shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me arsimin parauniversitar, arsimin e lartë në Kosovë, të gjitha çështjet e zhvillimit dhe të afirmimit të kulturës e të sportit në Kosovë, çështjet e pozitës së rinisë në shoqëri si dhe çështjet e diasporës dhe mërgatës. Sipas Rregullores dhe praktikës së punës së Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni ka hartuar planin e aktiviteteve për vitin 2016, i cili gjatë shqyrtimeve të mëvonshme mund të ndryshoj sipas nevojave dhe prioritetëve. Komisioni gjatë vitit 2016 aktivitete kryesore do t'i ketë shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe resorëve të Qeverisë që bien në kompetencë të tij.

Gjatë vitin 2016, Komisioni planifikon të shqyrtojë gjithsejtë nëntë (9) projektligje, tre (3) projektligje nga fusha e arsimit, shkencës dhe teknologjisë dhe gjashtë (6) projektligje nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit. Gjithashtu do të shqyrtohen edhe raportet vjetore të organeve të pavarura që bien në kompetencën e Komisionit. Komisioni planifikon të mbikëqyrë zbatimin e pesë (5) ligjeve, një (1) nga fusha e arsimit, tre (3) nga fusha e sportit e rinisë dhe një (1) nga diasporës dhe mërgatës.

Për të realizuar planin e vet, Komisioni do të mbajë mbledhje të rregullta, do të formojë grupe punuese për shqyrtimin e projektligjeve dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, do të organizojë degjime publike si dhe do të bëjë vizita nëpër institucionet qendrore dhe nëpër komuna.

Gjithashtu Komisioni do të bashkëpunoj me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me organizatat mbështetëse të Kuvendit, organizatat jo qeveritare vendore e ndërkombëtare nga fusha e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Diasporës e Mërgatës.

I. ANËTARËT² E KOMISIONIT DHE NJËSIA MBËSHTETËSE

Anëtarët e Komisionit :

1. NAIT HASANI/ Kryetar i Komisionit
Email : nait_hasani@hotmail.com
Tel. 044 – 255 554
2. SALIH MORINA / Zëvendëskryetar i parë
Email: salihmorina20@gmail.com
Tel. 044 – 182 543
3. SRDJAN POPOVIC¹/Zëvendëskryetare e dytë
Email : srdjan.popovich@gmail.com
Tel. 045 – 297 937
4. BEKIM HAXHIU
Email : bekimhaxhiu_@hotmail.com
Tel. 045 – 755 557
5. SHPEJTIM BULLIQI
Email : shbulliqi2000@yahoo.com
Tel. 044 539 438
6. ISMAJL KURTESHI
Email : ikurteshi@yahoo.com
Tel. 044 – 132 052
7. TEUTA HAXHIU
Email : teuta_haxhiu@hotmail.com
Tel. 044 – 857 870
8. SHUKRIJE BYTYQI
Email : shukrie.bytyqi@outlook.com
Tel. 044 – 717 508
9. MUFERA SINIK
Email : muferasinik@hotmail.com
Tel. 044 – 186 658

Stafi mbështetës :

1. Lule Ymeri / Koordinatorë
Email: lule.ymeri@assembly-kosova.org
Tel.: 038 – 211 331 / ext. 10 618
Mob.: 044 – 131 505
2. Shaip Goxhuli/Zyrtar i lartë i fushës/Analist
Email: shaip.goxhuli@assembly-kosova.org
Tel. : 038 – 213 643 / ext. 10 643
Mob.: 044 – 214 640

¹ Vendim Nr.05-V-077 për emërimin e deputetit Srdjan Popovic në vend të deputetes Jelena Bontic në Komisionin për Arsim me propozimin e G/P Lista Serbe, 15 maj 2015

² Vendim Nr. 05-V-005 për formimin e 14 Komisioneve parlamentare, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 18 dhjetor 2014

II. FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT³

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport është komision funksional. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësi, i shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Kosovë, të gjitha çështjet e zhvillimit dhe të afirmimit të kulturës e të sportit në Kosovë dhe çështjet e pozitës së rinisë në shoqëri. Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshin:

1. Shqyrtimin e legjislacionit arsimor në të gjitha nivelet arsimore dhe të fushës së shkencës, të teknologjisë, të kulturës, të rinisë dhe të sportit;
2. Çështjet që lidhen me planifikimin e zhvillimit strategjik dhe me koncipimin e politikës zhvillimore në lëmin e arsimit, të kulturës, të rinisë dhe të sportit;
3. Çështjet që lidhen me buxhetin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe të Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport;
4. Çështjet që lidhen me procesin e reformimit dhe të ngritjes së cilësisë të të gjitha niveleve arsimore, kulturore dhe shkencore në Kosovë;
5. Pozitën materiale të institucioneve arsimore, kulturore dhe shkencore të të punësuarve në këto institucione, etj.;
6. Çështjet që lidhen me procesin e reformimit dhe të ngritjes së cilësisë të të gjitha niveleve arsimore dhe kulturore në Kosovë;
7. Çështjet që lidhen me zhvillimin e teknologjive të reja dhe të inovacioneve në menaxhimin e resurseve publike dhe private;
8. Politikën e bashkëpunimit ndërkombëtar të Kosovës në lëmin e arsimit, të shkencës, të teknologjisë, të kulturës, të rinisë dhe të sportit;
9. Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
10. Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i tij;
11. Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.
12. Komisioni në kuadër të fushëveprimitarisë së tij ka edhe Ministrinë e Diasporës, me që aktivitetet e kësaj ministrie ndërlidhen me fushat që mbulon Komisioni.

³ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, shtojca nr. 2, pika 6.

Në ushtrimin e funksioneve Komisioni bashkëpunon me Ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohej nga Komisioni dhe i paraqet Kuvendit rekomandime përkatëse, përfshirë këtu edhe projektligjet dhe amendamentet përkatëse në fushën e legjislacionit, në fushën e arsimit, të shkencës, të teknologjisë, të kulturës, të rinisë dhe të sportit.

III. OBJEKTIVAT

Komisioni për realizimin e planit të punës për vitin 2016 do të përqëndrohet në këto objektiva të punës :

- a)* Shqyrtimi dhe amendamenti i projektligjeve që janë në kompetencë të Komisionit,
- b)* Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve,
- c)* Realizimi i vizitave brenda e jashtë vendit me qëllim të bashkëpunimit të Komisionit me institucione relevante, dhe
- d)* Shqyrtimi i raporteve të punës të organeve të themeluara nga Kuvendi që bien në kompetencën e Komisionit.

Për realizimin e këtyre objektivave, Komisioni shfrytëzon forma dhe metoda pune si janë:

- a)* Grumbullon informata përmes dëgjimeve publike dhe formave tjera të bashkëpunimit me qëllim të hartimit sa më të mirë të projektligjeve.
- b)* Formon nën komisione punuese, kur është e nevojshme, për të rritur efikasitetin dhe ekspertizën e tij.
- c)* Zgjedh së paku një ligj nën juridiksionin e tij për të mbikëqyrë implementimin e tij.
- d)* Bashkëpunon rregullisht me institucionet ekzekutive të Republikës së Kosovës,
- e)* Realizon vizita në teren për çështjet me interes në kuadër të fushëveprimtarisë së tij.
- f)* Bashkëpunon edhe me organizata relevante ndërkombëtare si: GIZ, UNICEF, USAID, NDI, UNDP, etj. punon drejt ngritjes së cilësisë së punës dhe bashkëpunimit me subjektet tjera.

IV. RREGULLA PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM

- Komisioni themelohet dhe funksionon në bazë të rregullores së Kuvendit;
- Dispozitat që rregullojnë kryesimin e Kuvendit janë bazë edhe për kryesimin e Komisionit;
- Komisioni ka Kryetarin dhe dy nënkryetarë;
- Komisioni ka stafin koordinues;
- Komisioni, me dy të tretat e votave, mund të krijojë një ose dy nën-komisione;
- Komisioni, për punë apo fusha të caktuara mund të krijojë grupe punuese;
- Nën-komisionet dhe grupet punuese i raportojnë komisionit;
- Komisioni mund ti caktojë anëtarët e tij si raportues për një çështje ose fushë të caktuar;
- Mbledhjet e komisioni i thirr dhe i kryeson kryetari, ose, në mungesë të tij, nënkryetari;
- Mbledhjen e Komisionit mund ta thërrasin edhe një e treta e anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni vendos me konsensus ose me shumicë votash;
- Deputeti që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës ka të drejtë t'i bashkëngjisë qëndrimin e vet raportit të Komisionit;
- Mbledhjet e Komisionit janë të hapura, përpos kur Komisioni vendos ndryshe;
- Në mbledhje të komisionit mund të ftohen dhe të marrin pjesë përfaqësuese të Qeverisë, përkatësisht ministrisë përkatëse, përfaqësues të institucioneve dhe asociacioneve të interesuar vendore e ndërkombëtare;
- Në punën e komisionit mund të angazhohen edhe këshilltarë ekspertë, në pajtim me udhëzimet procedurale e financiare të Kryesisë së Kuvendit;
- Komisioni në punën e tij mund të shfrytëzojë edhe ndihmën e ekspertëve, institucioneve dhe asociacioneve ndërkombëtar.

ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Kryetari:

- Drejton dhe koordinon punën e gjithmbarshme të Komisionit, në bashkëpunim me nënkryetarët;
- Përfaqëson Komisionin, vetëm ose së bashku me nënkryetarët dhe anëtarët e komisionit, varësisht nga natyra e përfaqësimit;
- Raporton para Kuvendit për punën e Komisionit dhe paraqet qëndrimet e Komisionit;
- Për çështje të caktuara mund ta autorizojë nënkryetarët ose anëtarët raportues që të paraqesin qëndrimet e Komisionit.

Nënkryetarët:

- Ndihmojnë kryetarin e Komisionit dhe e zëvendësojnë atë, kur ai mungon;
- Në marrëveshje me Kryetarin e Komisionit mbikëqyrin punën e grupeve punuese ose anëtarëve raportues për çështje ose fusha të caktuara, sipas vendimit të Komisionit;
- Në marrëveshje me Kryetarin e Komisionit paraqesin qëndrimet e Komisionit para Kuvendit.

Raportuesit:

- Anëtarët e komisionit mund të angazhohen për të raportuar për një çështje të caktuar, apo për të mbuluar dhe hulumtuar një fushë të caktuar dhe për t'i raportuar lidhur me të Komisionit;
- Me pëlqim të Komisionit dhe Kryetarit të tij, raportuesi mund t'i paraqesë qëndrimet e Komisionit edhe para Kuvendit.

V. PLANI I PUNËS SË KOMISIONIT

Gjatë vitin 2016, Komisioni planifikon të shqyrtojë gjithsejtë nëntë (9) projektligje, tre (3) projektligje nga fusha e arsimit, shkencës dhe teknologjisë dhe gjashtë (6) projektligje nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit. Gjithashtu do të shqyrtohen edhe raportet vjetore të organeve të pavarura që bien në kompetencën e Komisionit. Komisioni planifikon të mbikëqyrë zbatimin e pesë (5) ligjeve, një (1) nga fusha e arsimit, tre (3) nga fusha e sportit e rinisë dhe një (1) nga diasporës dhe mërgatës.

a) Shqyrtimi i projektligjeve:

1. *Shqyrtimi i projektligjeve nga fusha e arsimit, shkencës dhe teknologjisë (3)*

- 1.1. Projektligji nr.05/L-066 për Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës;
- 1.2. Projektligji nr. 05/L-074 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;
- 1.3. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/37 për inspeksionin e arsimit në Kosovë.

2. *Shqyrtimi i projektligjeve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit (6)*

- 2.1. Projektligji nr.05/L-050 për Kinematografinë;
- 2.2. Projektligji nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
- 2.3. Projektligji nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;
- 2.4. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore;
- 2.5. Projektligji për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve;
- 2.6. Projektligji për shfrytëzimin dhe menaxhimin e objekteve sportive.

b) Shqyrtimi i raporteve vjetore të punës së organeve të pavarura

Gjatë këtij viti Komisioni planifikon të shqyrtojë dy (2) raporte vjetore:

- Raport Vjetor i punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor⁴;
- Raporti vjetor i punës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim⁵;

c) Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve në fuqi dhe të institucioneve për zbatimin e politikave strategjike, Komisioni planifikon të mbikëqyrë zbatimin e pesë (5) ligjeve, një (1) nga fusha e arsimit, tre (3) nga fusha e sportit e rinisë dhe një (1) nga diasporës dhe mërgatës.

d) Vizitat brenda dhe jashtë vendit

Me qëllim të njohjes më të arriturat, prioritetet dhe sfidat në fushën e arsimit, shkencës, teknologjisë, kulturës, rinisë, sportit e diasporës e mërgatës, Komisioni do të realizojë vizita në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Diasporës, Universitetet Publike, Komunitet e Kosovës, Bartësit Privat të Arsimit të Lartë, Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe të Kulturës, Institucionet e Kulturës, Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe institucionet e tjera. Komisioni sipas nevojës do organizojë vizita jashtë vendit, me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave.

e) Shqyrtimi i raportit vjetor të shpenzimeve të Ministrive

Në kuadër të planit të punës së Komisionit për vitin 2016, planifikohet mbikëqyrja e shpenzimeve publike të Ministrive të linjës dhe institucioneve/organeve të pavarura me qëllim të rritet llogaridhënia e institucioneve përgjegjëse në mënyrën e shpenzimit të buxhetit. Komisioni do të shqyrtoj raportin vjetor të shpenzimeve të Ministrive të linjës dhe institucioneve/organeve të pavarura si dhe raportin gjashtë dhe nëntë mujor të shpenzimeve të Ministrive të linjës.

⁴ Neni 4, Ligji nr. 02/L-088 për Trashëgiminë Kulturorë

⁵ Neni 7, paragrafi 4, Ligji nr. 04/L – 037 për Arsimin e Lartë në Republikës e Kosovës

VII. AGJENDA E PUNËS SË KOMISIONIT SIPAS MUAJVE

PROGRAMI I PUNËS PËR SESIONIN PRANVEROR (JANAR – 31 KORRIK 2016)

1. Projektligjet në procedurë jashtë Programit Legjislativ të Qeverisë për vitin 2016

a) Projektligjet, në pritje për shqyrtim të parë

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i aktit</i>	<i>Sponsorues</i>	<i>Propozues</i>	<i>Shqyrtimi i parë</i>	<i>Komisioni funksional dhe raportues</i>	<i>Shqyrtimi i dytë</i>
1.	Projektligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës	MASHT	Qeveria	Shkurt 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Korrik 2016
2.	Projektligji për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit	MKRS	Qeveria	Shkurt 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Qershor 2016

b) Projektligjet në procedurë të shqyrtimit në Komision

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i aktit</i>	<i>Sponsorues</i>	<i>Propozues</i>	<i>Komisioni funksional dhe raportues</i>	<i>Shqyrtimi i dytë</i>
1.	Projektligji nr.05/L-050 për Kinematografinë	MKRS	Qeveria	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Prill 2016
2.	Projektligji nr.05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta	MKRS	Qeveria	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Prill 2016
3.	Projektligji nr.05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës	MASHT	Qeveria	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Prill 2016
4.	Projektligji nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive	MKRS	Qeveria	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Maj 2016

2. Projektligjet nga Programi legjislativ i Qeverisë për vitin 2016

Nr.	Emërtimi i aktit	Sponsorues	Propozues	Afati i parashtrimit	Shqyrtimi i parë	Komisioni funksional dhe raportues	Shqyrtimi i dytë
1.	Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore	MKRS	Qeveria	30.6.2016	Korrik 2016	Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	Në Sesionin vjeshtor
2.	Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/37 për inspeksionin e arsimit në Kosovë	MASHT	Qeveria	30.6.2016	Korrik 2016	Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	Në sesionin vjeshtor

3. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Nr.	Emërtimi i aktit	Komisioni funksional dhe raportues	Shqyrtimi i raportit në seancë plenare
1.	Ligji nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës	Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	Prill 2016
2.	Ligjin nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport dhe Ligjit nr. 2003/24 për Sport	Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	Korrik 2016

4. Raportimi i agjencive të pavarura

Nr.	Emërtimi i institucionit	Afati ligjor i parashtrimit të raporti	Komisioni funksional dhe raportues	Shqyrtimi i raportit në seancë plenare
1.	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Mars 2016	Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	Prill 2016
2.	Agjencia e Kosovës për Akreditim	Mars 2016	Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport	Prill 2016

5. Shqyrtimi i raportit vjetor të shpenzimeve të Ministrive

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i institucionit</i>	<i>Afati ligjor i parashtrimit të raportit</i>	<i>Komisioni funksional dhe raportues</i>	<i>Shqyrtimi i raportit në seancë plenare</i>
1.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Mars 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Prill 2016
2.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Mars 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Prill 2016
3.	Ministria e Diasporës	Mars 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Prill 2016
4.	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulture	Mars 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Prill 2016

6. Shqyrtimi i raportit gjashtë(6) mujor të shpenzimeve të Ministrive

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i institucionit</i>	<i>Afati ligjor i parashtrimit të raportit</i>	<i>Komisioni funksional dhe raportues</i>	<i>Shqyrtimi i raportit në Komision</i>
1.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Qershor 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Korrik 2016
2.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Qershor 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Korrik 2016
3.	Ministria e Diasporës	Qershor 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Korrik 2016
4.	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulture	Qershor 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Korrik 2016

PROGRAMI I PUNËS PËR SESIONIN VJESHTOR (SHTATOR – 31 DHJETOR 2016)**1. Shqyrtimi i dytë i projektligjeve**

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i aktit</i>	<i>Sponzorues</i>	<i>Propozues</i>	<i>Komisioni funksional dhe raportues</i>	<i>Shqyrtimi i dytë</i>
1.	Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore	MKRS	Qeveria	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Nëntor 2016
2.	Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/37 për inspeksionin e arsimit në Kosovë	MASHT	Qeveria	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Nëntor 2016

2. Projektligjet nga Programi legjislativ i Qeverisë për vitin 2016

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i aktit</i>	<i>Sponzorues</i>	<i>Propozues</i>	<i>Afati i parashtrimit</i>	<i>Shqyrtimi i parë</i>	<i>Komisioni funksional dhe raportues</i>	<i>Shqyrtimi i dytë</i>
1.	Projektligji për shfrytëzimin dhe menaxhimin e objekteve sportive	MKRS	Qeveria	30.11.2016	Dhjetor 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	
2.	Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017	MF	Qeveria	31.10.2016	Nëntor 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i> <i>Pjesën e buxhetit të Ministrive të linjës</i>	

3. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i aktit</i>	<i>Komisioni funksional dhe raportues</i>	<i>Shqyrtimi i raportit në seancë plenare</i>
1.	Ligjin nr. 04/L – 095 për Diasporën dhe Mërgatën	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Tetor 2016
2.	Ligji nr. 03/l-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Nëntor 2016

4. Shqyrtimi i raportit nëntë(9) mujor të shpenzimeve të Ministrive

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i institucionit</i>	<i>Afati ligjor i parashtrimit të raportit</i>	<i>Komisioni funksional dhe raportues</i>	<i>Shqyrtimi i raportit në Komision</i>
1.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Shtator 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Tetor 2016
2.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Shtator 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Tetor 2016
3.	Ministria e Diasporës	Shtator 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Tetor 2016
4.	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë	Shtator 2016	<i>Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport</i>	Tetor 2016

Përgatitur nga:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Prishtinë, 16 shkurt 2016

Kryetari i Komisionit
NAIT HASANI